

RELACION

PËR

PROJEKVENDIMIN

PËR

MIRATIMIN E PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE DHE VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është miratimi i Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit rishikimi i në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 458, datë 10.07.2024 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe Planin e Veprimit 2023–2025”, të ndryshuar”, duke shfuqiuar vendimit të këshillit të ministrave nr.499, datë 29.08.2018 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”.

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për mbrojtjen e viktimave të trafikimit kanë për qëllim të ofrojnë një kuadër të qartë, të harmonizuar dhe funksional për të gjitha hallkat institucionale shtetërore dhe jo-shtetërore të përfshira në trajtimin e këtij fenomeni kompleks dhe të ndjeshëm.

Ato përcaktojnë hapat që duhen ndjekur dhe ndarjen e qartë të përgjegjësi ndërmjet aktorëve të përfshirë në të gjitha fazat e procesit – nga identifikimi fillestar i një rasti të mundshëm, deri te mbështetja afatgjatë dhe riintegrimi i viktimës në shoqëri.

Këto procedura janë ndërtuar mbi parimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe vendosin në qendër të veprimit viktimën, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse, të ndjeshme ndaj gjinisë dhe moshës, si dhe të përshtatur me nevojat individuale të çdo rasti. Ato synojnë jo vetëm parandalimin e trafikimit, por edhe një përgjigje efektive dhe të koordinuar për identifikimin, mbrojtjen, asistencën, kthimin vullnetar të asistuar dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme – pavarësisht nëse janë shtetas shqiptarë apo të huaj, dhe pavarësisht nëse janë të identifikuar brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Procedurat i përgjigjen nevojës për një sistem të qëndrueshëm institucional, i cili garanton që asnjë viktimë apo viktime e mundshme të mos mbetet jashtë vëmendjes, dhe që çdo institucion të veprojë në mënyrë të koordinuar dhe të standardizuar, pa mbivendosje apo boshllëqe në përgjegjësi.

Në të njëjtën kohë, PSV-të përfaqësojnë një hap të rëndësishëm në përafrimin e kuadrit rregullator dhe praktikës shqiptare me standardet e Bashkimit Evropian, si dhe me rekomandimet e vazhdueshme të raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë vlerësuar reagimin institucional ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri. Në përmbajtjen dhe strukturën e tyre, procedurat marrin në konsideratë nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të mekanizmave ekzistues, sidomos në drejtim të kapaciteteve për identifikimin formal, hetimin, ndihmën psiko-sociale, ndjekjen penale të autorëve dhe mbështetjen për viktimat në rrugën drejt një jete të re dhe të sigurt.

Në këtë kontekst, PSV-të janë konceptuar si një mjet pune praktik, referencë ligjore dhe udhërrëfyes operacional për të gjitha institucionet që janë pjesë e mekanizmit kombëtar për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore – përfshirë Policinë e Shtetit, shërbimet sociale rajonale dhe lokale, shërbimet e punësimit dhe aftësimit profesional, autoritetet vendore, institucionet arsimore dhe shëndetësore, si dhe organizatat joqeveritare dhe partnerët ndërkombëtarë.

Zbatimi efektiv i këtyre procedurave është një kusht thelbësor për garantimin e mbrojtjes së plotë dhe të qëndrueshme të viktimave të trafikimit, për rritjen e efikasitetit institucional dhe për forcimin e besimit të viktimave në institucionet shqiptare.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, është planifikuar në 4 mujorin e III, në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, për vitin 2025 për Ministrinë e Brendshme.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ministria e Brendshme, vlerëson të domosdoshme miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit pasi nëpërmjet këtyre procedurave:

- Përcaktohen qartë indikatorët për të rriturit dhe fëmijët, treguesit për format e shfrytëzimit, duke evidentuar institucionet përgjegjëse për identifikimin fillestar dhe atë formal.
- I kushtohet një rëndësi specifike intervistimit dhe kushteve për zhvillimin e intervistës. Pjesa që nuk është shumë e qartë dhe që i mungon PSV-ve aktuale është mbështetja afatgjatë dhe riintegrimi ekonomik i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

- Anëtarët respektivë të Autoritetit Përgjegjës do të kenë detyra të qarta dhe specifike për secilin nga hapat;
- Dokumenti është në sintoni të plotë me aktet ligjore të miratuara, sikurse sipas Ligjit për Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, Ligjit për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, etj.
- Përcaktohen në mënyrë të detajuar formatet e dokumentimit dhe procesi i monitorimit. Nëse në PSV-të aktuale, nuk parashikohet një proces ankimi, këto procedura pasqyrojnë ngritjen e Komisionit të Posaçëm Ndërinstitucional për shqyrtimin e ankimeve për statusin e viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit, të shoqëruar me formatet përkatëse.
- Risi e projektvendimit është edhe parashikimi i vendimit për njohjen e statusit të viktimës dhe viktimës së mundshme të trafikimit pra, njohja e statusit do të vërtetohet nëpërmjet një dokumenti “vendimi”, jo vetëm për viktimat e mundshme të trafikimit por edhe për viktimat e trafikimit.

Këto Procedura zbërthejnë dhe qartësojnë akoma më mirë rolin, detyrat dhe përgjegjësitë që kanë të gjitha institucionet dhe agjencitë e përfshira në procesin e identifikimit dhe referimit të viktimave të trafikimit.

Procedurat përfshijnë të gjitha veprimet e kryera nga punonjës të institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore dhe joshetërore-anëtare të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare jo anëtare të MKR-së me/pa programe për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit për pritjen, identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe ndihmën për rehabilitimin dhe ri-integrimin e sigurt të personave të trafikuar në përputhje me këto procedura.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektvendimi është në përputhje të plotë me pikën 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", nenit 24 të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.458, datë 10.7.2024 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe Planin e Veprimit 2023–2025", të ndryshuar.

Projektvendimi "Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit", gjen mbështetje në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002, "Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj", si dhe në

ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

Gjithashtu, Procedurat Standarde bazohen në eksperiencën e deritanishme në zbatim të:

- Vendimit Nr. 499, datë 29.08.2018 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Procedurave Standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”;
- Detyrimeve që rrjedhin nga “Marrëveshja e Bashkëpunimit për Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave”, rishikuar në vitin 2023; nga udhëzimi i përbashkët nr.132, datë 08.09.2023 “Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ri integrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”; nga Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Për procedurat e bashkëpunimit për identifikimin e rasteve të punës së detyruar dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin për punë”.

Po ashtu, Procedurat janë hartuar në të njëjtën frymë me instrumentet ndërkombëtare që trajtojnë çështjet e parandalimit të trafikimit, mbrojtjes së personave të trafikuar dhe ndjekjes penale të trafikantëve, dhe reflektojnë rekomandimet e dhëna për të njëjtën fushë veprimi nga organizma ndërkombëtarë, si OKB, DASH, KiE, OSBE, etj.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektvendimi nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit përcaktojnë hapat për mbrojtjen në kohën dhe mënyrën e duhur të personave të trafikuar, në rrezik trafikimi, të rritur apo të mitur, për të gjithë llojet e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar.

Fokusi kryesor i këtyre procedurave është viktimat dhe mbrojtja e saj, duke shqyrtuar çdo situatë rast pas rasti dhe duke ndërtuar disa standarde të pranueshme nga të gjithë për mënyrën sesi do të zhvillohet i gjithë procesi i identifikimit, referimit dhe më pas, i mbrojtjes së viktimës së trafikimit. Duhet theksuar se, këto procedura zbatohen për të gjitha kategoritë e viktimave/viktimave të mundshme (të mitur dhe të rritur, femra dhe meshkuj, shqiptarë dhe të huaj) që janë subjekt i trafikimit për të gjitha llojet e shfrytëzimit.

Në mënyrë të detajuar parashikohen:

- treguesit, hapat që duhet të ndjekin punonjësit e vijës së parë për identifikimin dhe reagimin formal të viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit;
- veprimet që duhet të ndërmarrin për intervistimin e fëmijës/të rriturit;
- strukturat e intervistimit për fëmijë/të rritur; dokumentimi sipas formateve standarde;
- e drejta për ankimim dhe krijimi i Komisionit të Posaçëm Ndërinstitucional;
- masat emergjente dhe vendosja e fëmijës/të rriturit në strehëza;
- kthimi vullnetar i asistuar dhe pritja e personave të trafikuar me shtetësi shqiptare;
- Mbështetja e hetimit dhe dënimit të trafikantëve;
- Mbështetja afatgjatë dhe riintegrimi social-ekonomik i viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit;
- Formatet për zbatimin e procedurave standarde.

Procedurat parashikojnë situata në të cilat vendi ynë, apo zona të caktuara të vendit, përdoren, apo mund të përdoren si vend origjine, tranziti dhe destinacioni për lëvizjen dhe shfrytëzimin e personave të trafikuar shqiptarë dhe të huaj, si edhe situata në të cilat personat e trafikuar me shtetësi shqiptare, apo të hamendësuar shqiptare ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Procedurat nënkuptojnë ndërhyrje të specializuar sektoriale dhe ndërsektoriale/multidisiplinare dhe zbatimi i tyre është detyrim i të gjitha institucioneve shtetërore, në nivel qendror dhe vendor që punojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo janë me mision shtetëror jashtë vendit, si dhe bashkëpunimin me strukturat analoge të shteteve të huaja.

Gjithashtu, zbatimi i Procedurave Standarde është i detyrueshëm edhe për agjencitë joshtetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, në çdo moment në të cilin ato, gjatë veprimtarisë së tyre, bien në kontakt me një person që dyshojnë se mund të jetë trafikuar apo kanë informacion se është person i trafikuar.

Megjithëse është fryt i përpjekjeve të bashkërenduara të qeverisë, organizatave shërbim ofruese për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë, përgjegjësia për zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit është e institucioneve shtetërore.

Identifikimi dhe referimi për ndihmë i personave të trafikuar bëhet në bashkërendim dhe bashkëpunim të plotë të të gjitha autoriteteve dhe strukturave shtetërore ose joshtetërore.

Kthimi vullnetar i asistuar për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit do të mundësohet dhe garantohet nga vendi i origjinës dhe i destinacionit, duke bërë vlerësimin e situatës së personave në vendin dhe familjen e origjinës para kthimit dhe marrjen e vendimit të kthimit në interesin më të lartë të tyre, duke u bazuar në raportin për vlerësimin e situatës familjare dhe rrezikut para kthimit, si dhe në autorizimin e prindit/kujdestarit për kthim të asistuar të fëmijës.

Pjesëmarrja e organizatave shërbim ofruese për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, shoqërisë civile është e domosdoshme për arritjen e synimeve të Procedurave Standarde të Veprimit, d.m.th. mbrojtjen, parandalimin dhe ndihmën ndaj viktimave të këtij krimi.

Procedurat ruajnë ato elementë të vlerësuar si pikat më të forta në luftën kundër trafikimit, por edhe duke u përditësuar me një qasje të re në përgjigje të nevojave dhe kontekstit të ri në të cilin ndodhemi. Në këtë dokument janë ruajtur elementë të rëndësishëm që kanë të bëjnë me gjithë përfshirjen e agjencive shtetërore dhe joshtetërore, si dhe shtrirjen e veprimit të tij në të gjithë territorin e vendit, duke e vënë theksin sërish në forcimin e kapaciteteve dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

VIII. MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi u hartua nga Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP), ngritur me Urdhrin nr. 243, datë 24.12.2024 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për rishikimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.499, datë 29.08.2018 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”. Për hartimin e këtij dokumenti janë organizuar tre takime të GNP-së, konkretisht: më datë 8 prill, 23 prill dhe 19-20 maj. Gjatë takimeve, anëtarët e GNP-së dhanë mendime dhe sugjerime mbi draftin, të cilat janë reflektuar në dokument. Pas takimit dyditor (19-20 maj), drafti u dërgua për komente finale grupit të punës dhe më pas u përcoll pranë Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit

Rregullator për vlerësim dhe dërgimin e praktikës për mendim pranë ministrive të linjës.

Ministria e Financave nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet parimisht dakord, duke kërkuar që efektet financiare të projektvendimit të përballohen brenda tavaneve buxhetore të miratuara për institucionet e ngarkuara me zbatimin e tij.

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet parimisht dakord, duke sugjeruar:

- “Ky projektakt lidhet me aspekte që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe prandaj në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore, duhet t’i nënshtrohet konsultimit me ato në Këshillin Konsultativ”, **sqarojmë se**, do t’i përcillet Këshillit Konsultativ, në takimin e radhës.
- Në pikën 3 të projektvendimit ngarkohet për zbatimin e tij ndër të tjera Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe jo njësitë e vetëqeverisjes vendore që do të duhet të zbatojnë procedurat standarde në përditshmëri në terren. Për sa më sipër, sugjerojmë përfshirjen e njësive si subjekte që ngarkohen me zbatimin e projektaktit dhe heqjen e Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, **sqarojmë se u reflektua**.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet parimisht dakord, duke sugjeruar:

- Në faqen 8, të dokumentit të procedurave, tek parimet e përgjithshme, në pjesën mbi identifikimin dhe reagimin fillestar, togfjalëshi “*shkollat dhe institucionet arsimore*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*institucione arsimore*”, në kushtet që shkollat janë lloj i institucioneve arsimore. Ky sugjerim të mbahet në konsideratë për unifikim në përmbajtjen e të gjithë dokumentacionit të përcjellë, **sqarojmë se u reflektua**.
- Lidhur me...togfjalëshi “*Ministria e Arsimit dhe Sporteve*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*Ministria e Arsimit dhe Sportit*”... **sqarojmë se u reflektua**.
- Lidhur me...togfjalëshi “*Arsimi 9-vjeçar*” të zëvendësohet me termin “*arsimi bazë*” në përputhje me terminologjinë e ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky sugjerim të reflektohet edhe në përmbajtje të të gjithë dokumentacionit. Gjithashtu, në faqen 69 dhe 72 të draftit, togfjalëshi “*Arsimi i mesëm*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*Arsimi i mesëm i lartë*”, **sqarojmë se u reflektua**.

Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet si më poshtë:

1. Në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe Planin e Veprimit 2023–2025”, i ndryshuar, parashikohet si masë prioritare rishikimi i vendimit nr. 499, datë 29.8.2018,

të Këshillit të Ministrave. Në vijim, në vendimin nr. 818, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projekteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025", parashikohet miratimi i aktit "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.499, datë 29.08.2018 "Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit". Sa më sipër, sugjerojmë që rregullimet e synuara me projektvendimin e përcjellë për mendim të bëhen me një akt ndryshues të vendimit në fuqi dhe jo duke e shfuqizuar atë. Lidhur me sugjerimin vlerësojmë se duhet të shfuqizohet akti ekzistues pasi, projektakti i propozuar ka prodhuar risi në formwn pwrmbajtwore të tij. Konkretisht,

- parashikimi i vendimit për njohjen e statusit të viktimës dhe viktimës së mundshme të trafikimit, i cili nuk ka qenë parashikuar në VKM nr.499, datë 29.08.2018;
- parashikimi i ngritjes së Komisionit të Posaçëm Ndërinstitucional, si organ epror që shqyrton ankimimin administrative të paraqitur ndaj vendimit të dhënë nga grupi i identifikimit formal, në rast të mosdakordësisë me vendimin e dhënë;
- ndryshime thelbësore janë reflektuar edhe në formatet e intervistës fillestare dhe formale për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit;
- janë parashikuar treguesit për të rriturit dhe tregues për të miturit dhe brenda këtyre kategorive janë përfshirë edhe nënkategoritë e treguesve për të huajt, duke pasur parasysh praninë në rritje të të huajve në Shqipëri, kryesisht për qëllime punësimi.
- Janë parashikuar kushtet për zhvillimin e intervistës, duke garantuar pjesëmarrjen dhe konfidencialitetin e përkthyesit (në rastet kur intervistohet një person i huaj);
- janë parashikuar treguesit dhe indikatorët për shfrytëzimin për puën të detyruar, lypje dhe krime të vogla;
- është parashikuar pjesëmarrja e personave të tretë në intervistë, kushtet e intervistimit, kohëzgjatja dhe informimi i intervistuesit mbi të drejtat e tij;
- parashikohen procedura në lidhje me masat emergjente për fëmijët, akomodimi i fëmijëve dhe të rriturve në qendrat e emergjencës, në strehëz;
- regjistrimi i fëmijëve në gjendjen civile ëshët risi dhe adresim i një problematike të evidentuar gjatë zbatimit të PSV-ve aktual;
- Mbështetja afatgjatë dhe riintegrimi socio-ekonomik i viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, e parashikuar në projektakt, do të mundësojë riintegrimin e tyre në shoqëri e cila sjell edhe mosviktimizimin e tyre dhe ndalimin e ritrafikimit;
- Qasja e re dhe inovative reflektohet e dhe tek formatet e dokumentimit që janë parashikuar në projektakt, në ndryshim nga ato ekzistuese që janë një numër i konsiderueshëm dhe, në shumicën e tyre të paaplikueshëm;
- Vlen të theksohet fakti që, këto procedura janë hartuar edhe "në dritën" e Direktivës 1712/2024 që ndryshon Direktivën 2011/36/BE "Për

parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij";

Gjithashtu, projektakti është hartuar duke pasur parasysh gjetjet, problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të procedurave ekzistuese dhe problematikave të adresuara për zgjidhje në Autoritet Përgjegjës.

2. Sa i takon përkufizimeve sugjerojmë të shtohet termi "*person i besuar*" që në kuptim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, është personi madhor i kërkuar nga i mituri dhe i pranuar nga organi kompetent, i cili shoqëron të miturin në fazat e procedimit penal. Gjithashtu përkufizimi "*prind*" sugjerojmë të jetë i harmonizuar dhe në përputhje me paragrafin 16, të nenit 3, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili e përkufizon "*përfaqësuesin ligjor*" si prindi, i afërmi ose kujdestari i të miturit, i cili merr pjesë në procedurën e drejtësisë penale për të mitur për të mbrojtur interesat e të miturit. Sqarojmë se u përfshi termi "*person i besuar*" tek përkufizimet. Lidhur me sugjerimin, që përkufizimi "*prind*" sugjerojmë të jetë i harmonizuar dhe në përputhje me paragrafin 16, të nenit 3, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, sqarojmë se përkufizimi i përdorur në teksti referohet përkufizimit të ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"
3. Në përmbajtje të projektvendimit, sa i takon vlerësimit të situatës, sugjerojmë të shtohet edhe vlerësimi i situatës psikologjike, krahas asaj shëndetësore, me qëllim dhënien e ndihmës psikologjike apo edhe këshillimet/shërbimet e mundshme që mund të ofrohen nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale, bazuar në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, **sqarojmë se u reflektua.**
4. Në përcaktimin e procedurave standarde që duhet të ndiqen për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, sugjerojmë që intervista të zhvillohet edhe në praninë e mbrojtësit dhe kur është rasti, personat të mund të përfitojë ndihmë juridike parësore me qëllim garantimin e të drejtave procedurale dhe ruajtjen e interesave ligjore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se u reflektua.**
5. Lidhur me kushtet për zhvillimin e intervistës, sugjerojmë të parashikohet parimi i ndalimit të zhvillimit të intervistës 2 herë për të njëjtin fakt për të miturin, me qëllim shmangien e rëndimit të gjendjes psikologjike të tij, **sqarojmë se u reflektua.**
6. Në këtë projektvendim është parashikuar krijimi i Komisionit të Posaçëm Ndërinstitucional, si organ epror që shqyrton ankimin administrativ të paraqitur ndaj vendimit të dhënë nga grupi i identifikimit formal. Ky Komision parashikohet të jetë i përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, përfshirë këtu dhe Ministrinë e Drejtësisë. Në këtë kuadër, sugjerojmë të përcaktohen kompetencat dhe detyrat funksionale, si dhe roli që duhet të ketë anëtari i Komisionit të Posaçëm Ndërinstitucional, **sqarojmë se u reflektua.**
7. Lidhur me pjesën që përshkruan mbështetjen afatgjatë dhe ri/integrimin social ekonomik, sugjerojmë që termi "zyrat e këshillimit ligjor falas" të

zëvendësohet me termin “qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore”, bazuar në shkronjën “d”, të nenit 3, të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, **sqarojmë se u reflektua.**

8. Në Kreun IV, të relacionit shpjegues, sugjerojmë heqjen e paragrafit të parë nga përmbajtja e tij, pasi nuk është në përputhje me parashikimin e bërë në projektvendim dhe nuk shërben si bazë ligjore për miratimin e tij. Gjithashtu, në Kreun V, sugjerojmë që termi “*projekturdhri*” të zëvendësohet me termin “*projektvendimi*”. Në vijim, sa i takon Kreut VII të relacionit, që parashikon institucionet dhe organet e ngarkuara me zbatimin e projektvendimit, sugjerojmë rishikimin e tyre në përputhje me pikën 3 të projektvendimit, me qëllim që këto dy parashikime të jenë në përputhje me njëra-tjetrën. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se u reflektua.**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet parimisht dakord, duke sugjeruar:

Në pikën 3, të projektvendimit, konstatojmë se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ngarkohet për zbatimin e vendimit, ndërkohë që në materialin bashkëlidhur projektvendimit nuk ka detyra konkrete për ministrinë, për më tepër që edhe në Kreun VII, të relacionit shoqërues, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk citohet si institucion për zbatimin e këtij vendimi. Për rrjedhojë, sugjerojmë rishikimin e pikës 3 të projektvendimit. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se u reflektua.**

Lidhur me sugjerimin....termi “*hotel*” të zëvendësohet me termin “*strukturë akomoduese*”, **sqarojmë se u reflektua.**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet si më poshtë:

1. Në Parimet e Përgjithshme, paragrafi: “*Ndihmë ekonomike*”, është mbështetja në para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar”, të zëvendësohet me paragrafin “*Ndihmë ekonomike*”, është mbështetja me para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, **sqarojmë se u reflektua.**

2. Në kapitullin “Referimi mbrojtja dhe asistenca”, pika Fëmijët: “*Punonjësi i rastit i qendrës së emergjencës/strukturës së specializuar për mbrojtje informon NJMF dhe APAP-in e ASHMDF-së. Me marrjen e njoftimit, APAP-i përcjell informacionin tek Sekretariati i AP-së dhe, nëse është e nevojshme, kërkon mbledhjen e menjëhershme të AP për menaxhimin e mëtejshëm të rastit. NJMF/PMF-ja monitoron referimin e rastit*”, sqarojmë se procedura e masave emergjente për fëmijët duhet të jetë në përputhje me Ligjin Nr.18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Sipas këtyre dispozitave, propozojmë që paragrafi të riformulohet si vijon: “*Në situatë të rrezikut të lartë dhe të menjëhershëm, për shkak të abuzimit,*

shfrytëzimit, trafikimit, neglizhimit apo çdo forme tjetër dhune dhe për të cilin punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e Policisë së Shtetit apo të prokurorisë kanë dyshime ose fakte se familja apo mjedisi ku qëndron fëmija nuk është i sigurt për të. PMF-ja inicion procesin për marrjen në mbrojtje të fëmijës dhe vendosjen e masës emergjente të mbrojtjes, duke njoftuar menjëherë drejtorin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki.

PMF-ja, bashkë me policinë fillimisht, marrin masa për garantimin e sigurisë fizike të fëmijës.

PMF-ja vlerëson, së pari, mundësinë për vendosjen e fëmijës pranë një të afërmi ose një familjeje kujdestare dhe nëse kjo nuk është e mundur, identifikon e njofton shërbimin e emergjencës më të përshtatshëm për fëmijën.

PMF-ja, policia dhe personi apo përfaqësuesi i institucionit ku vendoset fëmija nënshkruajnë procesverbalin për marrjen e fëmijës në mbrojtje të menjëhershme (aneksi nr.10), i cili përmban arsyet për marrjen e këtij vendimi.

PMF harton dhe depoziton në gjykatën e rrethit, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit për masën, kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative.

PMF-ja merr pjesë dhe ndjek të gjitha seancat gjyqësore, në lidhje me konfirmimin e masës emergjente të mbrojtjes dhe vendosjen e fëmijës në kujdestari, si dhe përgatit dokumentet e kërkuara nga gjykata në procesin gjyqësor.

PMF-ja lehtëson zbatimin e vendimit përfundimtar të gjykatës, në lidhje me masën e mbrojtjes dhe vendosjen në kujdestari të fëmijës, nën drejtimin e drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki. Strukturat e shërbimit social shtetëror, rajonal, kanë detyrimin të ndërmjetësojnë dhe lehtësojnë zbatimin e këtij vendimi

Nëse gjykata e vendos fëmijën në kujdestari të një personi apo institucioni të ndryshëm nga ai i caktuar në masën emergjente të mbrojtjes, drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore/Shërbimi Social Shtetëror marrin masa për zbatimin e vendimit të gjykatës". Lidhur me këtë sugjerim sqarojmë se, e gjithë procedura e përmendur më sipër do të detajohet në udhëzuesin/manualin i cili do të hartohet pas miratimit të këtij projektvendimi.

3. Lidhur me përcaktimin në paragrafin: "NJMF njofton APAP-in e ASHMDF-së. Me marrjen e njoftimit, APAP-i përcjell informacionin tek Sekretariati i AP-së dhe, nëse është e nevojshme, kërkon mbledhjen e menjëhershme të AP për menaxhimin e mëtejshëm të rastit. NJMF/PMF-ja monitoron referimin e rastit, sugjerojmë të riformulohet: "Punonjësi i rastit i qendrës së emergjencës/strukturës së specializuar për mbrojtje informon NJMF. NJMF mund të njoftojnë APAP e ASHMDF në raste kur institucionet nuk i përgjigjen gjatë procesit të menaxhimit të rastit. Me marrjen e njoftimit, APAP-i përcjell

informacionin tek Sekretariati i AP-së dhe nëse është e nevojshme, kërkon mbledhjen e menjëhershme të AP për të diskutuar në lidhje me vështirësitë e konstatuara në menaxhimin e rastit dhe mos përgjigje nga institucionet përgjegjëse”, **sqarojmë se u reflektua.**

4. Në kapitullin “Vendosja e fëmijës në qendrën e emergjencës”, paragrafi “Punonjësi i rastit (punonjës social ose psikolog) referon rastin tek NJMF pasi të sigurohet që nevojat bazë të fëmijës janë plotësuar”, sugjerojmë të riformulohet “Punonjësi i rastit të qendrës mban kontakte të vazhdueshme me NJMF, në lidhje me çdo situatë, që ndikon në mirëqenien zhvillimin apo rrezikon sigurinë e fëmijës. Mban kontakte të vazhdueshme me PMF-në, i cili shërben si menaxher rasti për fëmijën, ndaj të cilit ofrohen shërbimet në kuadër të PIM-it, si dhe njofton PMF-në në lidhje me çdo situatë që ndikon në mirëqenien, zhvillimin apo rrezikon sigurinë e fëmijës”, **sqarojmë se u reflektua.**

5. Në kapitullin “Vendosja e fëmijës në qendrën e emergjencës”, paragrafi “Nëse nga vlerësimi i kryer apo bazuar në kërkesën për rikthim në familje/familje kujdestare nga familjarë apo vetë fëmija, vendoset që fëmija të kthehet në familje apo familjen kujdestare, punonjësi i rastit njofton menjëherë APAP-in e ASHMDF-së dhe NJMF-në. NJMF-ja do të vazhdojë me monitorimin e mëtejshëm të situatës dhe për të parandaluar rikthimin e mundshëm në rrezik trafikimi. Sa më sipër, sqarojmë që nxjerrja e fëmijës nga institucioni duhet të bëhet nëpërmjet ndryshimit të masës së mbrojtjes, sipas procedurave të parashikuara në Ligjin nr.18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Propozojmë që paragrafi të riformulohet me këtë përmbajtje: “Në rast se vlerësohet se fëmija është i gatshëm të dalë nga institucioni dhe familja/ familja kujdestare është një mjedis i përshtatshëm ku mund të vazhdojë të jetojë fëmija, atëherë mbledhet GTN (ku duhet të marrin pjesë aktorët që e njohin rastin si dhe përfaqësues të qendrës), me qëllim ndryshimin e masës së mbrojtjes. Pas këtij vendimi PMF harton “masën për vendosjen e fëmijës në kujdesje alternative pranë familjes/familjes kujdestare”. Kjo masë miratohet nga Drejtori i Shërbimeve Sociale në bashki dhe dërgohet për miratim në Gjykatë”, **sqarojmë se u reflektua.**

6. Në kapitullin vendosja e fëmijës në strehëz në paragrafin “Menaxheri i rastit njofton APAP-in e ASHMDF-së për organizimin e intervistës formale. APAP-i i ASHMDF-së njofton NJMF dhe punonjësën e policisë për kryerjen e intervistës formale”, sugjerojmë të riformulohet: “Menaxheri i rastit brenda në qendër/ strehëz njofton NJMF përkatëse aty ku fëmija ka vendbanimin për organizimin e intervistës formale. Menaxheri i rastit i qendrës/ strehëzës njofton NJMF dhe punonjësën e policisë për kryerjen e intervistës formale”, **sqarojmë se u reflektua.**

7. Paragrafi “Në rast se fëmija është i huaj, menaxheri i rastit nis menjëherë procedurat për sigurimin e lejes së qëndrimit për fëmijën”, sugjerojmë të riformulohet: “Në rast se fëmija është i huaj, menaxheri i rastit në qendër/strehëz nis menjëherë procedurat për sigurimin e lejes së qëndrimit për fëmijën”, **sqarojmë se u reflektua.**

8. Në pikën "Në rast të largimit të fëmijës nga qendra pa leje, menaxheri i rastit njofton menjëherë APAP dhe bën kallëzimin në strukturat vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm në DPQ. APAP-i i ASHMDF-së njofton Sekretariatën e AP. (faqe 23), sugjerojmë të riformulohet me këtë përmbajtje: "Në rast të largimit të fëmijës nga qendra pa leje, menaxheri i rastit të qendrës bën kallëzimin në strukturat vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm në DPQ, njofton menjëherë NJMF-në dhe Sekretariatën e AP", **sqarojmë se u reflektua.**

9. "Në rast të referimit të fëmijës në familje/familjen kujdestare, menaxheri i rastit njofton periodikisht NJMF-në për ecurinë dhe informon APAP", sugjerojmë të riformulohet: "Në rast të referimit të fëmijës në familje/familjen kujdestare, NJMF-informon periodikisht APAP e ASHMDF-së, në lidhje me monitorimin dhe ecurinë e rastit, **sqarojmë se u reflektua.**

10. Në formularin C3 FORMULAR PRANIMI NË QENDËR EMERGJENCE/STREHËZ PËR FËMIJË [emri i institucionit]nr. prot. tiranë, në paragrafin detyrimet e palëve, ku citohet që "personi ka të drejtë të largohet vullnetarisht në çdo kohë, duke nënshkruar një deklaratë përkatëse", sugjerojmë që *ky paragraf të hiqet*, pasi një fëmijë nuk ka të drejtë për të vepruar i vetëm, për aq kohë sa vendimi i vendosjes së fëmijës në qendër është marrë nga drejtori i shërbimeve sociale në bashki dhe gjykata. Në këtë kuptim edhe dalja e fëmijës nga qendra duhet të bëhet nga një masë e marrë nga drejtori i shërbimeve sociale në bashki dhe gjykata, **sqarojmë se u reflektua.**

11. Në Rubrikën III, të Relacionit shpjegues të projektaktit, sugjerojmë që togfjalëshi "...Ligjit të Përfshirjes Sociale...", të zëvendësohet me togfjalëshin "...Ligjit për Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë..", **sqarojmë se u reflektua.**

12. Po në këtë rubrikë duhet sqarohet më qartë dhe më saktë paragrafi që përcakton se: *risi e projektvendimit është edhe parashikimi i vendimit për njohjen e statusit të viktimës dhe viktimës së mundshme të trafikimit, duke marrë parasysh faktin që njohja e këtij statusi ka qenë e mundur edhe më parë*, **sqarojmë se u reflektua.**

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i Procedurave Standarde të Veprimit, angazhon të gjithë të sigurojnë zbatimin e detyrave të përcaktuara në këtë dokument dhe nën përgjegjësinë e tyre përkatëse, përfshirë sigurimin e burimeve të kërkuara. Për zbatimin e procedurave nëpërmjet aktiviteteve dhe masave të duhura, do të planifikohen dhe buxhetohen nga secila Ministri/strukturë, fondet e nevojshme në PBA-të përkatëse.

MINISTRI

ERVIN HOXHA

